



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Grupit Punues, i emëruar me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.14/14 të datës 7 qershor 2023, për themelimin e Muzeut të Gjenocidit dhe Përppjekjes për Liri ('Muzeu').
2. Muzeu, nga pika 1. e këtij Vendimi, do të bëjë dokumentimin dhe prezantimin e krimeve të ish Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj shqiptarëve dhe të tjerëve në Kosovë.
3. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndërmarrjen e hapave për:
 - 3.1. Themelimin e Muzeut, fillimisht si njësi të veçantë në kuadër të Muzeut Kombëtar të Kosovës, si institucion i kulturës në bazë të legjislacionit të aplikueshëm deri në aprovimin e Ligjit për Muzetë, si institucion të pavarur muzeal të nivelit kombëtar;
 - 3.2. Zhvillimin e procedurave përkatëse për vendosjen e institucionit të Muzeut në ndërtesën ku është aktualisht e vendosur Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
 - 3.3. Hartimin e detyrës projektuese për konceptin muzeor dhe kuratorial si dhe për konceptin arkitektonik dhe hapësinor të ndërtesës së Muzeut;
 - 3.4. Zhvillimin e procedurave për zbatimin e projektit për konceptin muzeor dhe kuratorial, arkitektonik dhe hapësinor të Muzeut.
4. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Proccsverbalit dhe Transkripti nga mbledhja e 230 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 229, 231, 232, 234 dhe 235 elektronike /korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë.
2. Projektligji nga pika 1. c këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Prodhimin, Kultivimin, Grumbullimin, Përpunimin, Tregtimin, Kontrollin e Duhanit, Produktet e Duhanit dhe Produktet e Ndërlidhura.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Detyrat, Përbërjen, Funkcionimin dhe Kompensimin e Komisioneve në Agjencinë Antidoping.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/I.-197 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Vedat Maxhuni, emërohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria për Komunitete dhe Kthim për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Luan Sylaj, emërohet Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/238
Datë: 18.12.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për Themelimin e Task Forcës për Mbrojtjen dhe Shfrytëzimin e Ligjshëm të Pyjeve

- Formohet Task Forca për Shfrytëzimin e Ligjshëm të Pyjeve, në këtë përbërje:
 - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kryesues;
 - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtar;
 - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtare;
 - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore të Kosovës, anëtar;
 - Policia e Kosovës, anëtar;
 - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar;
 - Këshilli Prokurorial i Kosovës, anëtar;
 - Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar;
 - Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave, anëtar;
 - Shoqata e Pronarëve të Pyjeve Private, anëtar;
 - Shoqata e Përpunuesve të drurit, anëtar.
- Miratohen Termat e Referencës për funksionimin e Task Forcës për Shfrytëzimin e Ligjshëm të Pyjeve (Shtojca 1).
- Mënyra e funksionalizimit, organizimit, aktivitetet dhe obligimet e Task Forcës për Mbrojtjen dhe Shfrytëzimin e Ligjshëm të Pyjeve janë të përcaktuara në Termat e Referencës sipas pikës 2. të këtij vendimi.
- Task Forca për shfrytëzimin e ligjshëm të Pyjeve nxjerrë Rregulloren e saj të brendshme të punës.
- Mandati fillestar i Task Forcës për Shfrytëzimin e Ligjshëm të Pyjeve zgjatë tri (3) vite.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja -Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

TERMAT E REFERENCËS SË
TASK FORCËS PËR SHFRYTËZIMIN E LIGJSHËM TË PYJEVE¹⁴

Historiku

Kosova i sheh pyjet e saj si pjesë e thesarit/trashëgimisë kombëtare. Ligji për Pyjet e konfirmon këtë: *"Pyjet e Kosovës janë resurs kombëtar. Ato do të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe atyre të ardhshme. Menaxhimi i pyjeve do të marrë parasysh gjithashtu edhe interesat tjera publike".* Në këtë kontekst, funksionet ekonomike, sociale dhe ekologjike të pyjeve kanë rëndësi shumë të madhe për zhvillim e qëndrueshëm të Kosovës dhe për përmirësimin e cilësisë së jetesës, veçanërisht në zonat rurale dhe ato malore.

Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve dhe tokave pyjore në Kosovë vlerësohet të jetë 481,600 ha¹⁵, e cila përbën 44% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës. Prej kësaj, rreth 60% janë pyje publike, derisa 40% i takojnë pronarëve privatë, ndër ta shpesh familje me prona të vogla, jetesa e të cilave varet nga pyjet dhe produktet pyjore.

Prerjet e qëndrueshme vjetore, bruto, vlerësohen të jenë 1.45 milionë m³, me rreth 630 000 m³ me pyje të cilësisë së lartë dhe 815 000 m³ në pyje të cilësisë së ulët si cungishte. Sido që të jetë, Raporti i inventarizimit rekomandon që prerjet vjetore në Kosovë të jenë rreth 1.2 milionë m³, gjë që paraqet dukshëm një sasi me lartë se sasia e raportuar si prerje ligjore në pyjet publike dhe private. Në realitet, prerjet vjetore të masës druore arrijnë në 1.6 milionë m³, që paraqet nivelin prej 1/4 më të lartë se sa niveli afatgjatë i rekomanduar. Për më tepër, aktualisht vetëm 10 - 15% e vëllimit të përgjithshëm pritet sipas rregulloreve ekzistuese. Arsyet kryesore për këtë janë aktivitetet e shumta pyjore të paligjshme, prona pyjore private të fragmentuara dhe të vogla (mesatarisht një/dy hektarë), dhe shkalla e ulët e zbatimit të Planeve Menaxhuese të Pyjeve (PMP).

¹⁴ Shfrytëzimi i lëndëve të drurit në mënyrë të ligjshme: i referohet jo vetëm prerjeve, por edhe prodhimit, shfrytëzimit/menaxhimit të lëndëve të drurit sipas Ligjit për Pyjet

¹⁵ Të dhënat nga Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve i realizuar në vitin 2012.

Derisa pyjet e Kosovës përfaqësojnë një burim të madh të potencialit ekonomik, praktikat aktuale të pylltarisë karakterizohen gjithandej me prerje joformale dhe të paligjshme, me sundim të dobët të ligjit, sisteme joefikase dhe joefektive të qeverisjes dhe nuk krijojnë të ardhura të konsiderueshme për potencialin ekonomik që kanë. Kjo shpie në humbje të të hyrave ekonomike për komunitetet lokale dhe në dobësimin e jetesës së qëndrueshme. Për më tepër, shpyllëzimi i parregullt po shkakton degradim të mjedisit duke pasur efekte të mëdha negative në mjedis, si dhe në ekonominë rurale e kësisoj edhe në ekonominë e përgjithshme të Kosovës.

Prerjet e parregullta janë kombinim i prerjes dhe tërheqjes së lëndës së drurit në sasi të vogël për shkak të varfërisë dhe nga banorët rural. Ndërsa prerjet ilegale janë prerje në sasi më të madhe dhe për qëllime tregtare dhe të organizuara. Të dyja këto aktivitete rezultojnë në humbje të konsiderueshme të të hyrave për autoritetet dhe shkaktojnë konflikte në zonat rurale pyjore.

Në bazë të përvojave ndërkombëtare dhe punës së FAO-s në të kaluarën, këtu janë paraqitur disa tregues të përbashkët që paraqesin shtimin e rrezikut prej shfrytëzimit të paligjshëm të pyjeve, ndërsa më pas janë dhe disa tregues tjerë që mund të drejtojnë daljen prej asaj gjendje. Këta tregues gjithësesi i përgjigjen edhe situatës së Kosovës.

Kriminalizimi i sistemit të pylltarisë zakonisht ndodhë:

- Kur pylli perceptohet si pronë e përbashkët - atëherë ai nuk është në përgjegjësinë e askujt;
- Kur vlerat e masës drunore janë shumë të larta krahasuar me të ardhurat;
- Kur autoritetet nuk kanë kapacitetin për të monitoruar dhe për të kontrolluar situatën në pyje;

Ndërsa dekriminalizimi i sistemit të pylltarisë mund të bëhet:

- Kur një grup mirë i përcaktuar me përgjegjësi i merr të drejtat për përfitime;
- Kur ky grup që gëzon përfitimet ndërmerr veprime adekuate për të monitoruar dhe për të mbrojtur pyllin;

Në Kosovë, në tërësi relativë, ekziston struktura ligjore për drejtimin e aktiviteteve në sektorin pyjor. Ekziston Ligji për Pyjet dhe ligjet e tjera që kanë të bëjnë me pyjet në një kuptim më të gjerë. Ekziston po ashtu një numër i akteve nënligjore (*udhëzime administrative*). Megjithatë, pavarësisht këtij legjisllacioni mbështetës, një prej sfidave më të mëdha është mungesa e respektimit dhe zbatimit të ligjeve. Kjo situatë duket se varet nga shumë arsye: (i) Stafi dhe subjektet e ndërlidhura nuk janë në dijeni për kornizën ligjore, (ii) korniza ligjore neglizhohet meqë konsiderohet se pengon operacionet/aktivitetet, (iii) ka mungesë mbikëqyrjeje dhe zbatim të ligjeve dhe (iv) policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor nuk vijojnë rregullisht raportet mbi shkeljet e ligjit.

Rezultatet përfundimtare të këtyre problemeve të vazhdueshme mund të shpijnë nganjëherë në:

- Qeveria inkason të hyra nën-optimale nga shitja e lëndës së drurit,
- Lejet për prerje që lëshohen nganjëherë bazohen në kritere joformale,
- Një treg i lëndës së drurit që nuk është plotësisht transparent, si rezultat nuk promovon efikasitet dhe biznese të shëndetshme,
- Humbje në shfrytëzimin efikas të lëndës së drurit, posaçërisht atëherë kur pritet në mënyrë të paligjshme,
- Menaxhimi i pyjeve nuk zbatohet me konsistencë, duke çuar kështu në uljen e produktivitetit dhe zvogëlimin e vlerave të trungjeve, dhe
- Pyjet nuk mbrohen nga zjarri dhe insektet dëmtuese.

Për shkak të karakterit të sektorit, duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve, dhe presionin e vazhdueshëm dhe të shtuar ndaj pyjeve, të cilat po vijnë kryesisht nga problemet socio-ekonomike dhe industriale, është e qartë se duhet të përfshihen një numër i ministrive dhe palëve të tjera të interesit për të ndërmarrë veprime koherente dhe për të pasur zbatim të suksesshëm të bazës ligjore për pyjet dhe programet zhvillimore për to. Kjo kërkon një bashkërendim të kujdesshëm të aktiviteteve dhe kontributin e akterëve të ndryshëm përmes mekanizmave të ndryshëm ndër-institucionalë.

Objektivi

Kompleksiteti, mangësitë dhe problemet me të cilat përballlet pylltaria në Kosovë paraqet nevojën për krijimin e një mekanizmi i cili mundëson një koordinim të fuqishëm institucional, për t'i arritur objektivat e përcaktuara në programet zhvillimore, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim Politikat dhe Strategjia për Zhvillimit të Sektorit të Pylltarisë, Programi ekzistues dhe i ardhshëm i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkë me kornizën e tij ligjore themelore.

Për më tepër, shkalla e shfrytëzimit të paqëndrueshëm dhe të paligjshëm të burimeve pyjore është dëshmia e qartë e kësaj situatë. Ky është një arsye i fortë i nevojave për krijimin e një Task Force për të siguruar një koordinim ndër-institucional për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e ligjshme të pyjeve.

Prandaj, qëllimi kryesor për të pasur një Task Forcë të tillë është që të unifikohen përpjekjet ndër-institucionale për zhdukjen e aktiviteteve të paligjshme në pyje dhe në tregtinë e lëndës së drurit, dhe të arrihet konsensus i cili përcillet me veprime për ta kthyer vëmendjen e publikut drejt ruajtjes së pyjeve dhe drurit me vlera të larta nga druri vetëm për zjarr dhe tregjet joformale.

Mandati, struktura dhe përbërja

Shfrytëzimin i ligjshëm i pyjeve kërkon përfshirjen e shumë akterëve në vend. Prandaj, për të siguruar një bashkëpunim të fortë midis institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal në kundërveprimet ndaj aktiviteteve të paligjshme pyjore, dhe për të ndërmarrë masat parandaluese për mbrojtjen e pyjeve, është e nevojshme që të vendoset një mekanizëm qendror. Themelimi i një Task Forcë për ligjshmerinë e shfrytëzimit të ligjit, mund t'i bashkojë përpjekjet ndër-institucionale për zbatimin e ligjit në pylltari.

Kjo Task Forcë duhet të përbëhet nga institucionet përkatëse, të cilat janë përgjegjëse dhe të përfshira (*niveli qendror dhe lokal*) në aktivitete që lidhen me pyjet, ato që sigurojnë koordinim dhe bashkëpunim më të mirë dhe që ndërmarrin veprime më të shpeshta për të parandaluar aktivitetet e paligjshme pyjore. Përveç institucioneve shtetërore, Task Forca përfaqësonë institucionet përkatëse, sektorin privat dhe diversitetin etnik dhe rajonal të Kosovës.

Task Forca për shfrytëzimin e ligjshëm të pyjeve përbëhet nga:

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (*Ministri*);
2. Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (*Ministri*);
3. Ministria e Punëve të Brendshme (*Ministri*);
4. Ministria e Pushtetit Lokal (*Ministri*);
5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (*Ministri*)

6. Agjencioni i Pyjeve të Kosovës (*Kryeshefi Ekzekutiv*);
7. Asociacioni i Pronarëve Privatë të Pyjeve në Kosovë
8. Policia, MPB
9. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
10. Këshilli Prokurorial,
11. Këshilli Gjyqësor,
12. Shoqata e përpunuesve të drurit

Varësisht prej nevojave dhe rrethanave, Task Forca ka të drejtë të ftojë ministri, institucione, organizata dhe palë të tjera të përfshira për të adresuar aspekte të caktuara pyjore.

Mandati i dytë i Task Forcës është tre vjet nga data e përfundimit të mandatit të parë.

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë

Task Forca merr parasysh përgjegjësitë ligjore të secilit institucion të përfaqësuar gjatë ushtrimit të rolit të saj dhe nuk ndërhyr në mandatet e tyre të garantuara me legjislacionin në fuqi.

Aktivitetet kryesore të Task Forcës përfshijnë, por jo dhe kufizohen në:

- Të përcaktojë një plan operativ me prioritete dhe veprime të përbashkëta, në mënyrë që të sigurohet koordinimi ndërinstitucional për të parandaluar dhe zhdukur aktivitetet e paligjshme në pyje;
- Të përgatisë dhe paraqes të dhënat e kërkuara dhe të japë kontributin e duhur, sipas institucioneve përkatëse, për të luftuar aktivitetet e paligjshme pyjore;
- Të sigurojë koordinim siç kërkohet duke adresuar sfidat me të cilat përballen në zbatimin e ligjit;
- Të rekomandojë intervenimet e duhura në politika dhe legjislacion për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe për Qeverinë lidhur me promovimin e shfrytëzimit të ligjshëm dhe mbrojtjen e përgjithshme të pyjeve;
- Të marrë pjesë në trajnime për zbulimin dhe reagimin ndaj aktiviteteve të paligjshme pyjore dhe përgatitjen/realizimin e fushatave të ndryshme për zbatimin e ligjit në pylltari.
- të kryejë një vlerësim të aktiviteteve që janë në zbatim e sipër, duke rekomanduar çdo përmirësim të nevojshëm.

Rezultatet e pritura

Rezultatet që priten nga aktivitetet e realizuara nga Task Forca, gjatë vitit të parë përfshijnë:

- Një plan operacional i dakorduar, i specifikuar me koordinim ndërinstitucional dhe përgjegjësitë e përcaktuara të anëtarëve për zhdukjen e shfrytëzimit të paligjshëm dhe joformal të pyjeve në Kosovë;
- Një sistem i dakorduar për monitorim dhe vlerësim, bashkë me tregues të përcaktuar për matjen e progresit të veprimeve të përbashkëta ndër-institucionale kundër operacioneve të paligjshme pyjore;
- Akterët kryesorë dhe anëtarët e Task Forcës trajnohen për metodat më të reja për zbulimin dhe reagimin ndaj aktiviteteve të paligjshme në pyje;

- Dakordim për mesazhet kryesore që mund të përdoren për fushatat ndërgjegjësuere rreth vlerave pyjore dhe rolin e tyre në zhvillimin dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Vlerësimin e aktiviteteve të vazhdueshme për shfrytëzimin e ligjshëm të pyjeve, jepen rekomandime dhe këshilla për përsëritjet eventuale, për riorientimin e aktiviteteve dhe adresimin e fokuseve për zhvillim.

Takimet e Task Forcës

Task Forca takohet së paku tri herë në vit, ose me kërkesë të shumicës së anëtarëve;

Në bazë të vendimit të Qeverisë për themelimin e Task Forces, Task Forca e mbështetur nga Sekretariati i saj përgatit dhe mirato rregulloren e saj të brendshme.

Kryesuesi i Task Forcës ka autoritetin për të thirrur takimet. Njoftimi për datën e takimeve duhet dhënë së paku dy javë përpara;

Të gjitha vendimet e Task Forcës miratohen me shumicën e votave të anëtarëve present në takim.

Sekretariati i Task Forcës

Task Forca mbështetet nga sekretariati i saj, në këtë rast Departamenti i Pylltarisë /MBPZHR dhe Ekipi i Menaxhimit të Projektit (EMP) të FAO-s "Mbështetje për fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve për të përmirësuar jetesën rurale dhe për të adresuar ndryshimin klimatik në Kosovë". EMP vepron si Sekretariat, i cili lehtëson punën e Task Forcës.

Sekretariati është përgjegjës për organizimin e takimeve dhe lehtësimin e zbatimit të vendimeve të Task Forcës në përputhje me planin e punës së aprovuar. Sekretariati kujdeset për çështjet administrative të organizimit të takimeve të Task Forcës, për organizimin e trajnimeve të nevojshme dhe hartimin e një plani pune të detajuar për miratim dhe për të ndihmuar Task Forcën sipas kërkesës në zbatimin e këtij plani.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/238
Datë: 18.12.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 30 paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007, të nenit 15 paragrafit 1. të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për transfer të mjeteve buxhetore në shumë prej 450,000€ (katërqind e pesëdhjetë mijë euro), deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të kategorisë së shpenzimeve Investimeve kapitale të nën-programit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për mbulimin e obligimeve.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Këshillit Gjyqësor i Kosovës, me kod 328, nga nën programi Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me kod 33300, nga kategoria e shpenzimeve të "Investimeve Kapitale", transferi është -24.51% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të nën-programit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (duke përfshirë të gjitha transferet e realizuara në këtë nën program gjatë vitit 2024), nga projektet, si në vijim:
 - 2.1. Nga projekti "Dizajnimi dhe ndërtimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Drenas" me kod 18804, në shumë prej 220,000€; dhe
 - 2.2. Nga projekti "Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan Dega në Viti" me kod 18555, në shumë prej 230,000€.
3. Mjetet nga pika 2. e këtij vendimi transferohen në nën-programet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:
 - 3.1. Nën-programin "Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës" me kod 33300, kategoria e shpenzimeve "Subvencionet dhe Transfere" shuma prej 100,000€;
 - 3.2. Nën-programin "Gjykata e Apelit" me kod 38000, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 10,000€;
 - 3.3. Nën-programi "Gjykata Themelore në Prishtinë" me kod 38100, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 50,000€;
 - 3.4. Nën-programi "Gjykata Themelore në Prizren" me kod 38200, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 40,000€;
 - 3.5. Nën-programi "Gjykata Themelore në Gjilan" me kod 38300, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 40,000€;
 - 3.6. Nën-programi "Gjykata Themelore në Ferizaj" me kod 38400, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 40,000€;

- 3.7. Nën-programi "Gjykata Themelore në Pejë" me kod 38500, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 80,000€;
 - 3.8. Nën-programi "Gjykata Themelore në Gjakovë" me kod 38600, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 40,000€;
 - 3.9. Nën-programi "Gjykata Themelore në Mitrovicë" me kod 38700, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" në shumë prej 50,000€.
4. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/238
Datë: 18.12.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish-shoqërore, të menaxhuara dhe administruara nga AKP të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Hanit të Elezit:
 - Rindërtimi i Fushës së Futbollit, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Rregullimi i pronësisë për Fabrikën e Ujit, Zona Kadastrale Dermjak, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Ndërtimi i Qendrës për Kulturë dhe Rini, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Zgjerimi i rrugës pranë Terminalit Doganor, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/ Komuna e Hanit të Elezit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Hanit të Elezit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/238
Datë: 18.12.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme të Ndërmarrjes Shoqërore "Kooperativa Bujqësore" Ropotovë e Madhe, ZK. Dobërçan që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, shpronësimi i të cilës është i nevojshëm për realizimin e projektit: Varrezat e Fshatit dhe Fusha Sportive në Dobërçan, ZK. Dobërçan, Komuna Gjilan, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Komuna e Gjilanit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/ Komuna e Gjilanit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/238
Datë: 18.12.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 7, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh. "Industria e Tekstilit Integj" parcela kadastrale Nr. 4945-7 dhe Objekti që menaxhohet dhe administrohet nga AKP, shpronësimi i të cilës është i nevojshëm për realizimin e projektit: "Çerdhe e fëmijëve, hapsirë gjelbëruese dhe infrastrukturë rrugore" Zona Kadastrale: Gjilan, Komuna Gjilan, sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bën shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Komuna e Gjilanit.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Gjilanit.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/238
Datë: 18.12.2024

